



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI

Komisioni i Ligjeve

RELACION per shtyrje

Per dekretin e Presidentit nr. 2804, dt. 23.11.2000
“Për kthimin e ligjit nr. 8678, dt. 2.11.2000
“Për organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise”

Ne kalendarin e punimeve te Kuvendit për periudhen 18-26 dhjetor 2000 eshte planifikuar edhe shqyrtimi i dekretit te Presidentit “Për kthimin e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise”.

Komisioni nuk e mori ne shqyrtim kete dekret meqenese nderkohe kane ardhur per miratim edhe dy p/ligje te tjera qe kane lidhje organike me nje nga arsyet e kthimit te ligjit ne fjale nga Presidenti dhe konkretisht te p/ligjeve “Për Prokurorine ne Republiken e Shqipërise” dhe “Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Larte te Drejtesise”.

Për kete arsye, Komisioni e gjykon te drejte qe shqyrtimi i dekretit te behet njekohesisht me dy p/ligjet e mesipërme, keshtu qe kerkojme shtyrjen nga seanca plenare e dates 26.12.2000 te dekretit te fjale.

Zamira ÇAKA

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI
Komisioni i Ligjeve

[Signature]
14.5.2001

RELACION

**Për dekretin e Presidentit, 2804, dt. 23.11.2000,
për kthimin e ligjit nr. 8678, dt. 2.11.2000 "Për organizimin dhe
funksionimin e Ministrise se Drejtesise"**

Komisioni i Ligjeve, ka marre ne shqyrtim dekretin e Presidentit "Për kthimin e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise".

Komisioni i Ligjeve, eshte njohur me motivet e kthimit te ligjit nga Presidenti, ka debatuar për nje kohe te gjate rreth argumentave qe ka sjelle Presidenti, pare kjo se bashku edhe me p/ligjin "Për Keshillin e Larte te Drejtesise" dhe ligjin "Për Prokurorine".

Komisioni pasi i diskutoi për nje kohe relativisht te gjate te treja ligjet ne fjale, përfundimisht u shpreh dakort për te bere ndryshimet perkatese ne ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise", ne ato nene qe përmend Presidenti ne dekretin e tij.

Keto ndryshime tashme menjanojne kundershite mes ketij ligji dhe p/ligjit "Për Keshillin e Larte te Drejtesise" dhe ligjit "Për Prokurorine" dhe sigurojne nje harmoni te plote mes tyre.

Komisioni beri keto ndryshime ne ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise:

- ✓ 1. Neni 4, pika 3, te hiqen ljalet "ne funksionet politike te Kabinetit te Ministrit dhe"
- ✓ 2. Neni 5, pika 2, te hiqen ljalet "dhe te garantoje"
- ✓ 3. Neni 6, pika 9, ne fund te fjalise te shtohen ljalet "sipas ligjit"

- 62
- ✓
- Pika 10, te riformulohet: “Kontrollon sipas ligjit organin e prokurorise dhe raporton te Presidenti i Republikes dhe ne Kuvend.”
3. Neni 11, pika 3, shkronja b) te riformulohet: “kryen inspektive ne gjykata dhe gjyqtare te veçante, sipas ligjit dhe përgatit rekomandime për Ministrin e Drejtesise lidhur me marrjen e masave te nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe për shkeljet e konstatuara;”
- shkronja c), fjalët kryen inspektive ne” te zevendesohen me fjalën “kontrollon”. ✓

Zamira ÇAKA

KRYETARE

Z. Çaka

Z. Çaka
14.5.2001